



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

PROJEKT VENDIM

Nr. 5249, datë 22.04.2026

“PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PLAZHEVE TË LEJUARA, VENDBAZIMEVE UJORE DHE ZONAVE TË AKTIVITETEVE REKREATIVE UJORE NË BREGDETIN RANA E HEDHUN, SHËNGJIN, KUNE, VAIN DHE TALE, PER SEZONIN TURISTIK VEROR 2026” PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PROCEDURAVE PËR ADMINISTRIMIN E VENDBAZIMEVE UJORE DHE AKTIVITETEVE REKREATIVE UJORE SI DHE TARIFAVE MAKSIMALE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Ne mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” i ndryshuar, sipas ligjit nr.107/2014, “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit” te ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Per Turizmin” te ndryshuar; ligjit nr.8743, date 22/02/2001, “Per pronat e paluajtshme te shtetit”, te ndryshuar, ligjit nr.9251, date 08/07/2004 “Kodi Detar i Republikes se Shqiperise” te ndryshuar; VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 Për Miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Stacionit të Plazhit” dhe relacionit të administratës së Bashkisë Lezhe, Kryetari Bashkisë;

PROPOZON :

1. Miratimin e hartës të plazheve të lejuara vendbazimeve ujore dhe zonave të aktiviteteve rekreative ujore në vijën bregdetare Rana e Hedhun, Shengjin, Kune, Vain dhe Tale për periudhën Maj 2026 – Nëntor 2026 sipas hartave bashkelidhur.
2. Miratimin e procedurës aplikimit nga subjektet e interesuara për vendbazime ose hapësirave për aktivitete rekreative ujore si vijon:
 - 2.1. Subjektet e interesuara për administrimin e vendbazimeve ose hapësirave për aktivitete rekreative ujore paraqesin kërkesën e tyre me dokumentacion shoqërues pranë NJQV.
 - 2.2. Dokumentacioni përfshin minimalisht:
 - a. të dhënat identifikuese të subjektit;
 - b. tipin e aktivitetit rekreativ ujqor dhe hapësirën e kërkuar për administrim;
 - c. planin e menaxhimit të aktivitetit, stafit dhe sigurisë në ujë;
 - d. certifikimet teknike dhe licencat për mjetet ujore që do të përdoren;
 - e. planin e menaxhimit mjedisor dhe ndikimit në habitatin ujqor;
 - f. provën e kapacitetit profesional dhe financiar.
 - g. provën e shlyerjes së detyrimeve fiskale vendore.

h. vetëdeklarimin se subjekti është njohur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe mban përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin tyre, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

i. dokumentacion tjetër të përcaktuar në aktet subjekt i vendimarrjes së NJQV.

2.3. Afatet, formulari standard dhe mënyra e aplikimit përcaktohen nga Kryetari i Bashkisë Lezhë.

3. Miratimin e procedurës së vlerësimit të kërkesave dhe lidhjes së kontratave për vendbazime ose hapësirave për aktivitete rekreative ujore, si vijon;

3.1. NJQV shqyrton kërkesat e subjekteve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së tyre dhe vlerëson përputhshmërinë me kriteret ligjore, teknike dhe të sigurisë.

3.2. Prioritet në miratim u jepet subjekteve që garantojnë:

- a. standarde më të larta sigurie në ujë;
- b. ndikim minimal mjedisor;
- c. shërbime cilësore dhe të aksesueshme për publikun.

3.3. Pas miratimit, NJQV lidh me subjektin kontratën e administrimit.

3.4. Dorëzimi i hapësirës bëhet, si më poshtë vijon:

- a. brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore ndan me procesverbal në terren koordinatat dhe njofton Policinë Bashkiake për monitorimin e veprimtarisë;
- b. një kopje e procesverbalit depozitohet në dosjen e aplikimit..

4. Detyrimet e Operatorëve të Vendbazimeve dhe Aktiviteteve Rekreative Ujore janë si vijon;

4.1. Operatorët që administrojnë vendbazime dhe aktivitete rekreative ujore janë të detyruar të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për turizmin, sigurinë në ujë, mjedisin, zonat e mbrojtura, rendin publik dhe këtë vendim.

4.2. Operatorët detyrohen të garantojnë:

- a. ofrimin e shërbimeve rekreative ujore në përputhje me standardet e sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së jetës së pushuesve;
- b. vendosjen e sinjalistikës detyruese të sigurisë për përdorimin e mjeteve ujore, me tabela të qarta në gjuhën shqipe, angleze dhe një gjuhë tjetër të përdorur nga turistët e zonës;
- c. pajisjen e detyrueshme të përdoruesve me jelekë shpëtimi dhe pajisje sigurie, pa pagesë shtesë për aktivitetet ku kërkohet;
- d. sigurimin e stafit të trajnuar dhe të certifikuar për drejtimin dhe mbikëqyrjen e mjeteve rekreative ujore, duke përfshirë të paktën 1 instruktor të licencuar për çdo grup prej 15 përdoruesish;

e. vendosjen e një pike të kontrollit dhe informacionit, të pajisur me listë çmimesh (kur ofrohen kundrejt pagesës), rregulla përdorimi, ndalim-përdorimi dhe plan emergjence;

f. ruajtjen e qetësisë publike, rendit dhe etikës turistike në zonën e administruar.

4.3. Operatorit ndalohet:

a. të kryejë aktivitet me mjete ujore motorike jashtë zonave të miratuara;

b. të lejojë përdorimin e mjeteve motorike nga persona të mitur apo persona pa autorizim;

c. të ndër marrë aktivitete që cenojnë habitatin ujor dhe bregdetar;

d. të zgjerojë hapësirën e administruar pa autorizim nga NJQV.

5. Për siguruar Standarde të Sigurisë dhe Menaxhimit Mjedisor për Vendbazimet dhe Aktivitetet Rekreative Ujore

5.1. Çdo vendbazim duhet të garantojë:

a. një plan sigurie në ujë të miratuar nga NJQV, i cili përcakton hapat e parandalimit, ndërhyrjes dhe menaxhimit të emergjencave;

b. stafin mbikëqyrës me certifikim për shpëtim në ujë, të pranishëm gjatë orarit të veprimtarisë;

c. mjetet e shpëtimit, sinjalizimin akustik dhe vizual, dhe pajisje të ndihmës së shpejtë;

d. masat për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë grumbullimin dhe largimin e mbetjeve, përdorimin e pajisjeve ekologjike dhe minimizimin e ndotjes akustike.

5.2. Operatorit i ndalohet çdo veprimtari që dëmton habitatin ujor, detar apo bregdetar, përfshirë hedhjen e vajrave, karburanteve, detergentëve ose substancave ndotëse.

6. Mbikëqyrja dhe Inspektimi i Veprimtarive Rekreative Ujore realizohet nga NJQV, e cila bashkëpunon me AKB dhe inspektoratet kompetente për turizmin, mjedisin, transportin ujor dhe rendin publik.

6.1. Inspektimet mund të jenë të planifikuara ose të befasishme dhe kryhen gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë.

6.2. Operatorët janë të detyruar të lejojnë akses të inspektorëve dhe të vënë në dispozicion dokumentacionin ligjor dhe teknik të veprimtarisë.

6.3. NJQV autorizohet të marrë Masa Administrative dhe Ndëshkimore për shkelje, ku;

6.3.1. Shkeljet kategorizohen si:

a. Të lehta – mospërputhje të vogla, që nuk rrezikojnë jetën e përdoruesve (korrigjim brenda 24 orëve);

b. Të mesme – mospërputhje që cenojnë cilësinë e shërbimit dhe sigurinë (gjobë administrative dhe korrigjim brenda 48 orëve);

c. Të rënda – shkelje që rrezikojnë jetën, cenojnë mjedisin ose aksesin publik, apo bien ndesh me detyrimet ligjore, dhe sjellin ndërprerjen e menjëhershme të kontratës.

6.3.2. Shkelje të rënda konsiderohen:

- a. përdorimi i mjeteve ujore motorike jashtë zonës së miratuar;
- b. lejimi i përdorimit të mjeteve pa pajisje sigurie;
- c. mosprezenca e personelit të certifikuar të sigurisë në ujë;
- d. ndotja e mjedisit ujor dhe bregdetar;
- e. pengimi i aksesit publik në zonën e autorizuar.

6.3.3. Në rast përsëritjeje, kontrata ndërpritet dhe subjekti përjashtohet nga procedurat për një periudhë 5-vjeçare.

7. Operatorët e stacioneve të plazhit u përcaktohen si tarifa tavan për ofrimin e shërbimit të plazhit;

Ne leke/dite

Lloji i shërbimit	Tale +Vain	Shengjin	Rana e Hedhun
Çader kashte/alumini + Shezlong alumini- varianti ekonomik	300	400	500
Çader alumini / kashte + Shezlong me profile druri me dyshek	700	800	1000
Gazebo plazhi- <i>familjare</i>	1,500	2,000	2,500

8. Detyrimi i operatorëve për shfrytëzimin e vendbazimeve është 100.000 Lekë/muaj për vendbazim.

9. Detyrimi i operatorëve të aktiviteteve rekreative ujore për shfrytëzimin e hapsirës ujore është 2.000 Lekë/muaj/m².

10. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për hartimin e dokumentacionit dhe dorëzimin e hapsirës operatorëve dhe organizimin e punës për inspektimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

11. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 5249/prot.

Lezhë, më 22/04/2026

RELACION

MBI PROJEKT VENDIMIN:

“PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PLAZHEVE TË LEJUARA, VENDBAZIMEVE UJORE DHE ZONAVE TË AKTIVITETEVE REKREATIVE UJORE NË BREGDETIN RANA E HEDHUN, SHËNGJIN, KUNE, VAIN DHE TALE, PER SEZONIN TURISTIK VEROR 2026” PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PROCEDURAVE PËR ADMINISTRIMIN E VENDBAZIMEVE UJORE DHE AKTIVITETEVE REKREATIVE UJORE SI DHE TARIFAVE MAKSIMALE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Ne mbeshetjete te ligjit nr. 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” i ndryshuar, sipas ligjit nr.107/2014,”Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit” te ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Per Turizmin” te ndryshuar; ligjit nr.8743, date 22/02/2001, “Per pronat e paluajtshme te shtetit”, te ndryshuar, ligjit nr.9251, date 08/07/2004 “Kodi Detar I Republikes se Shqiperise” te ndryshuar; VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 Për Miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”; si dhe me qëllim administrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen Kryetari i Bashkisë i paraqet projekt-vendimin përkatës per miratim, Këshillit të Bashkisë;

Ky projekt vendim ka si qellim;

- Miratimin e Hartës së Stacioneve të Plazhit të Vendbazimeve dhe aktiviteteve të rekreacionit ujor
- Normimin e kriterëve dhe procedurave për administrimin e vendbazimeve ujore
- Normimin e kriterëve dhe procedurave për administrimin e aktivitetit të rekreacioneve ujore
- Përcaktimin e tarifave tavan që operatorët e stacioneve të plazhit mund të përdorin në ofrimin e shërbimeve të tyre

Bashkëlidhur Projekt Vendimit është përgatitur materiali grafik për Hartën e Stacioneve të Plazhit. Kjo hartë presupozon ndarjen e plazhit në;

- Stacione Plazhi të Menaxhuara
- Stacione Plazhi që janë më kontrata aktive të miratuara në vitet e mëparshme
- Plazhe publike për qëndrim të përgjithshëm, të cilët do të administrohen nga Ndërmarrja Publike Lezha Invest
- Plazhe publike ku Bashkia ofron shërbime kundrejt tarifave dhe për menaxhimin e të cilëve ka angazhuar Ndërmarrjen publike Lezha Invest

Kjo hartë sugjeron që të propozojë

një sipërfaqe prej 82.822 m² për menaxhim nga operatorët me njesi akomoduese përkatësisht; Rana e Hedhun – 2.678 m², Shëngjin – 22.225 m², Vainë – 1.000 m² dhe Tale – 8.125 m²

një sipërfaqe prej 26.221 m² të angazhuar me kontrata ekzistuese nga njesi akomoduese përkatësisht; Rana e Hedhun - 13.091 m², Shëngjin – 60.606 m² dhe Tale – 1.318 m²

një sipërfaqe prej 428.565 m2 si plazh publik i lirë ose me opsionin e tarifimit nga Bashkia përkatësisht; Rana e Hedhun – 143.617 m2, Shëngjin – 51.374 m2, Vain – 66.875 m2 dhe Tale – 166.669 m2

Si rezultat, 80% e sipërfaqes i dedikohet përdorimit publik të plazhit, 15% në dispozicion të operatorëve të Njësive akomoduese, dhe 5% është ndërkohë e angazhuar nga kontrata të mëhershme dhe që janë aktive ende.

Në lidhje me vendbazimet ujore si dhe me aktivitetet rekreative ujore, Projekt Vëndimi i Këshillit Bashkisë bën përpjekje për të stabilizuar një set rregullash për administrimin e procesit. Përveç vendosjes së tyre në hartën e stacioneve të plazhit, ky projekt vendim përcakton

- Serinë e dokumentave që do duhet të kenë aplikantët për të patur të drejtën e administrimit të këtyre vendbazimeve
- Procedurën e aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit të administrimit dhe operimit të vendbazimeve ujore.
- Detyrimet për standarte sigurie në operim dhe ndalesat që kanë këto operatorë
- Procedurën e inspektimit të operimit të operatorëve

Në zbatim të VKM 649 datë 16.10.2024, të ndryshuar, projekt Vëndimi i Këshillit të Bashkisë reflekton risinë që sjellin ndryshimet e fundit në këtë VKM, të cilat parashikojnë mundësinë që i jepet bashkisë të përcaktimit të disa tarifave tavan me të cilat do mund të operojnë operatorët privatë për shërbimet që ofrojnë në stacionet e plazhit. Për këtë arsye sugjerohet përcaktimi i tarifave me nivele në varësi të zonave; Rana e Hedhun, Shëngjin dhe Tale/vain.

Gjithashtu Projekt Vëndimi i Këshillit Bashkiak përcakton tarifën që operatorët e vendbazimeve dhe ato të aktiviteteve rekreative ujore i detyrohen Bashkisë për të drejtën e përdorimit të sipërfaqeve publike dhe të drejtën e ushtrimit të këtyre aktiviteteve në territorin përkatës.

Duke marrë në konsideratë faktorët e zhvillimit të sektorit turistik, propozohet që Këshilli Bashkiak Lezhë të miratojë këtë Projekt Vëndim të Këshillit Bashkisë në funksion të mbarëvajtjes së sezonit veror 2026.

Ky vendim do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në territorin e Bashkisë Lezhë.

**KRYETAR
PJERIN NDREU**



Lidhja nr 1

TARIFAT MAKSIMALE PËR OFRIMIN E SHERBIMIT NË STACIONET E PLAZHIT

Lloji i sherbimit	Në lekë/ditë			Varianti
	Tale + Vain	Shengjin	Rana e Hedhun	
Çader kashte/alumin + Shezlong alumini	300	400	500	ekonomik
Çader alumini / kashte + Shezlong me profile druri me dyshek	700	800	1,000	Cillesor
Gazebo plazhi- <i>familjare</i>	1,500	2,000	2,500	Premium